



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr-01- 463102-64701 dt. 19/12 /2022

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika a dhe c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5 pika 1.3 dhe nenit 6 të Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komuna e Drenasit nxjerrë:

V E N D I M

Për publikimin e Listës së Përgjithshme të Pronave të Komunës së Drenasit, si dhe Listen e Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2023.

Neni 1

Me këtë vendim publikohet Lista e Përgjithshme e Pronave të Komunes së Drenasit e paraqitur në formë tabelare.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është edhe Lista e Veçantë Pronave që planifikohen për t'u dhënë në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2023, e cila përfshin të dhënat kadastrale të pronave, lokacionin dhe destinimin e tyre me PZHK dhe Hartë Zonale, si dhe paraqitjen tabelare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Për zbatimin e këtij Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtoria Përkatëse
- Arkivit



Kryetari i Komunës

Ramiz Vladoevci

A r s y e t i m

Komuna e Drenasit duke u bazuar në faktin se me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës do të krijohen kushte për zhvillimin e bizneseve, krijimin e mundësisë për investime nga investitorët vendor dhe të huaj me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës, dhe do të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë.

Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, Komuna do të inkason edhe të hyra komunale të cilat konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

Po ashtu Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 30.07.2020, ka miratuar Vendimin për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028, me të cilin është planifikuar zhvillimi ekonomik i Komunës së Drenasit, ku pjesë e këtij plani janë edhe pronat të cilat janë pjesë e Listës së Veçantë që planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2023.

Baza juridike për t'i publikuar këto lista është, neni neni 6, pika 1.3 dhe neni 13 te Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5 pika 1.3 dhe nenit 6 të Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Bashkangjitur me këtë vendim i gjeni:

- *Listën e Përgjithshme të Pronave të Komunës së Glllogocit*
- *Lista e Veçantë e Pronave që planifikohen për t'u dhënë në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2023*
- *Skicat e parcelave të cilat janë pjesë e listës së veçant.*